

**SMA Holding SH.P.K.**

**TIRANË - SHQIPËRI**

**SMA Holding SH.P.K.**


**TIRANA – ALBANIA**

**AKT THEMELIMI**

**ACT OF INCORPORATION**

**Më 02 nëntor 2023**

**On 02 November 2023**

A handwritten signature in blue ink, consisting of a large, stylized initial 'M' followed by a series of loops and a final vertical stroke.

Sot, më 02.11.2023, **Z. Xhevdet Rexhepi**, shtetas kosovar, i lindur më 27.05.1971, në Prishtinë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. P01607669 dhe me nr. personal 1013759738 (këtu e më poshtë referuar si "**Ortak i Vetëm**"), miratoi këtë Akt Themelimi, si më poshtë:

### Neni 1

#### Themelimi dhe forma ligjore

**Ortaku i Vetëm** deklaron krijimin dhe themelimin e një shoqërie shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, përkatësisht **SMA Holding Sh.p.k.** (këtu e më poshtë referuar si "**Shoqëria**"), në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("**Ligji për Shoqëritë Tregtare**"). Shoqëria do të themelohet për një kohëzgjatje të pakufizuar.

### Neni 2

#### Selia e regjistruar e Shoqërisë

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rr. "Sami Frashëri", Kulla Metropol, K2, 1001, Tiranë, Shqipëri.

### Neni 3

#### Objekti i aktivitetit të Shoqërisë

3.1 Objekti i Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- a) Organizimi si një shoqëri holding, e cila do të jetë zotëruese e plotë ose e pjesshme e kuotave, aksioneve dhe ose interesave në shoqëri të tjera në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga vetë Shoqëria apo ortakët e saj;
- b) Ofrimi i asistencës për shoqëritë në të cilat shoqëria holding është zotëruese e plotë ose e pjesshme e kuotave, aksioneve dhe ose interesave në ato shoqëri në mënyrë të

Today, on 02.11.2023, **Mr. Xhevdet Rexhepi**, Kosovar citizen, born on 27.05.1971, in Pristina, Kosovo, holder of passport with no. P01607669 and with personal no. 1013759738 (hereinafter referred to as the "**Sole Shareholder**"), adopted the present Act of Incorporation, as follows:

### Article 1

#### Establishment and legal form

**The Sole Shareholder** hereby declares the establishment and incorporation of an Albanian limited liability company, namely **SMA Holding Sh.p.k.** (hereinafter referred as the "**Company**"), in accordance with the provisions of the Albanian Law No. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" (the "**Company Law**"). The Company shall be established for an unlimited duration.

### Article 2

#### Address of the Company

The registered address of the Company is as follows: "Sami Frashëri" Street, Metropol Tower, 2<sup>nd</sup> floor, 1001, Tirana, Albania.

### Article 3

#### Scope of activities of the Company

3.1 The scope of activities of the Company are listed as per below:

- a) Organization as a holding company, which will be the full or partial owner of quotas, shares and/or interests in other companies, directly or indirectly, by the Company itself or its partners;
- b) Providing assistance to companies in which the holding company is the full or partial owner of quotas, shares and/or interests in those



drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga vetë Shoqëria apo ortakët e saj;

- c) Shoqëria mund të kryejë çdo dhe të gjitha veprimtaritë e nevojshme e të dobishme me qëllim realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

3.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, për përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria mund:

- a) të aplikojë dhe të pajiset me një ose të gjitha licencat dhe autorizimet e nevojshme, si dhe të kryejë aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër;
- b) të blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të lërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt (objekti i aktivitetit) të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj;
- c) të kryejë aktivitete publikimi, marketingu e reklamimi;
- d) të kryejë aktivitete import - eksporti të mallrave dhe/apo shërbimeve siç do të konsiderohet e nevojshme;
- e) të kryejë aktivitete për shitjen me pakicë apo shumicë të mallrave, pajisjeve siç mund të konsiderohet e përshtatshme;
- f) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

3.3 Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.


companies, directly or indirectly, by the Company itself or its partners;

- e) The Company can perform any and all necessary and useful activities in order to realize the object of its activity.

3.2 In compliance with the Albanian Legislation, in order to achieve said purposes, the Company may:

- a) file for and obtain any and all relevant licenses and authorizations as may be needed, and carry out any commercial, financial, renting, mortgage or pledge activities, which may be considered useful or necessary in order to achieve the Company's purpose, provided that such activities are not carried out to a greater extent than those stated above;
- b) acquire, directly or indirectly, interests in other companies, which have an object (scope of activities) similar to the Company, in Albania or abroad;
- c) perform publishing, marketing and advertising activities;
- d) carry out import-export of any and all goods and/or services, as may be deemed necessary;
- e) carry out retail and or wholesale of any goods, equipment, as it may deem appropriate;
- f) perform any other activity, which may be considered useful or necessary in order to achieve the Company's scope of activity.

3.3 The Company shall carry out any other activity that falls within its scope.



3.4 Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe standardet më të mira etike, në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 4**

#### **Statuti**

Ortaku i Vetëm deklaron miratimin dhe zbatimin e Statutit të Shoqërisë. Aktiviteti dhe veprimtaria e Shoqërisë do të kryhen në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe rregullat e detyrueshme të legjislacionit shqiptar.

#### **Neni 5**

#### **Kapitali**

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 10,000.00 (dhjetë mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë të zakonshme me vlerë nominale 10,000.00 (dhjetë mijë) lekë, plotësisht i nënshkruar dhe i shlyer, i zotëruar plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë:

- **Z. Xhevdet Rexhepi**, shtetas kosovar, i lindur më 27.05.1971, në Prishtinë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. P01607669 dhe me nr. personal 1013759738.

#### **Neni 6**

#### **Administratori**

6.1. Administratori i Shoqërisë është:

- **Z. Arbnor Gashi**, shtetas kosovar, i lindur më 01.03.1988, në Prishtinë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. P01939581 dhe me nr. personal 1171783905 ("Administratori").

6.2. Administratori emërohet për një afat në detyrë prej 3 (tre) vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

3.4 The Company will respect all relevant laws and regulations and the best ethical standards, in force in the Republic of Albania.

#### **Article 4**

#### **Articles of Association**

The Sole Shareholder hereby declares the adoption and execution of the Articles of the Association of the Company. The activity and the business of the Company shall be carried out in accordance with the Articles of the Association of the Company, and the mandatory rules of Albanian legislation.

#### **Article 5**

#### **Share Capital**

The share capital of the Company is ALL 10,000.00 (ten thousand Albanian Lek), consisting of 1 (one) ordinary share with a nominal value of ALL 10,000.00 (ten thousand Albanian Lek), fully subscribed and outstanding, owned entirely by the Sole Shareholder:

- **Mr. Xhevdet Rexhepi**, Kosovar citizen, born on 27.05.1971, in Pristina, Kosovo, holder of passport with no. P01607669 and with personal no. 1013759738.


#### **Article 6**

#### **Administrator**

6.1. The Administrator of the Company is:

- **Mr. Arbnor Gashi**, Kosovar citizen, born on 01.03.1988, in Pristina, Kosovo, holder of passport with no. P01607669 and with personal no. 1171783905 (the "Administrator").

6.2. The Administrator is elected for a term of 3 (three) years and can be re-elected.



6.3. Të gjitha detyrimet, të drejtat dhe kufizimet e Administratorit janë të detajuara në Statutin e Shoqërisë.

#### Neni 7

#### Autorizimet

Ortaku i Vetëm autorizon **Znj. Ana Goro**, shtetase shqiptare, e lindur më 03.03.1985, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. I55303082E dhe/ose **Znj. Juna Rexha**, shtetase shqiptare, e lindur më 25.12.1998, në Elbasan, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. J86225060S dhe/ose **Znj. Elona Mena**, shtetase shqiptare, e lindur më 11.02.1997, në F Kuqe, Shqipëri, me nr. personal ID J75211034C, bashkërisht ose individualisht, të hartojnë, nënshkruajnë, ekzekutojnë dhe dorëzojnë në emër të Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm për të plotësuar dhe bërë efektiv regjistrimin e **SMA Holding SH.P.K.**, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe çdo autoriteti kompetent tjetër siç kërkohet me ligj.

*Akti i Themelimit është hartuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.*

6.3. The duties, responsibilities and any limitations of the Administrator are provided in the Articles of Association of the Company.

#### Article 7

#### Authorizations

The Sole Shareholder hereby authorize **Ms. Ana Goro**, Albanian citizen, born on 03.03.1985, in Tirana, Albania, holder of ID with personal no. I55303082E and/or **Ms. Juna Rexha**, Albanian citizen, born on 25.12.1998, in Elbasan, Albania, holder of ID with personal no. J86225060S and/or **Ms. Elona Mena**, Albanian citizen, born on 11.02.1997, in F Kuqe, Albania, holder of ID with personal no. J75211034C, to jointly or individually, draft, sign, execute and deliver on behalf of the Company of any and all documents necessary to complete and make effective the registration of the **SMA Holding SH.P.K.**, with the National Business Centre, and any other competent authority as required by law.

*The Act of Incorporation is prepared in accordance with the provisions of the Albanian Law No. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" as amended.*

### ORTAKU I VETËM / THE SOLE SHAREHOLDER

#### XHEVDET REXHEPI

XHEVDET REXHEPI

SMA HOLDING SHPK  
RR. SAMI FRASHERI  
KULLA METROPOL  
SHQIPERI TIRANE 1001